

VENDIM
Nr. 72/2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 41/2017,
“PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VERIFIKIMIN E
KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT, SIPAS LIGJIT NR.
84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 8, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 41/2017, “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për verifikimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, në pikën II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në pikën II, shkronja “b”, nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

- | | |
|--------------------|------|
| 1. Oerd Bylykbashi | (PD) |
| 2. Flamur Noka | (PD) |
| 3. Fatmir Mediu | (PR) |

II. Shtohet pika II/1 me këtë përmbajtje:

- | | | |
|----------------|--------------------------|------|
| 1. Ulsi Manja | caktohet kryetar | (PS) |
| 2. Flamur Noka | caktohet zëvendëskryetar | (PD) |

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2017